

URDHËR
Nr. 545, datë 30.8.2021

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “AGJENCIA E ADMINISTRIMIT KOLEKTIV
FABER COLLECTIVE PHONOGRAM” NË ADMINISTRIMIN KOLEKTIV NË
FUSHËN E TË DREJTAVE TË PRODHUESVE TË FONOGRAMIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 134, 135, 157 dhe 158, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të udhëzimit nr. 385, datë 13.10.2020, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës, në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, ‘Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to’”, të ndryshuar, si dhe të legjislationit në fuqi “Për organizatat jofitimprurëse”,

URDHËROJ:

1. Licencimin e “Agjencisë së Administrimit Kolektiv *Faber Collective Phonogram*”, si agjenci e administrimit kolektiv në fushën e të drejtave të prodhuesve të fonogramit.
2. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë si agjenci e administrimit kolektiv është e vlefshme për 3 (tre) vjet, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
3. Ngarkohet Drejtoria e së Drejtës së Autorit për njoftimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti